



Elterngespräche in Kindergarten und 1. Klasse

Hintergrundinformationen

Entwicklungsbereiche

Dieses Dokument ist eine Übersetzungshilfe zuhanden fremdsprachiger Eltern.

Bisedat me prindër në kopsht dhe në klasën e parë

Informacione plotësuese

Fushat zhvillimore

Ky dokument është një ndihmë e përkthyer për prindërit me gjuhë të huaj amtare.

Shpjegimet e mëposhtme rjedhin nga Plani mësimor 21 i Cyrihut.

Trupi, shëndeti, motorika

Fëmijët e përjetojnë trupin e tyre si qendër dhe e zbulojnë botën përmes veprimit të tyre. Mundësitë e shumta të lëvizjes e ndihmojnë zhvillimin e tyre të shëndoshë fizik dhe psikik.

Fëmija...

- është aktiv, provon dhe ushtron forma të ndryshme të lëvizjes;
- përimiton lëvizjet dhe shkathtësitë e tij motorike;
- ushtron aftësitë e tij koordinuese;
- shpreh përmes trupit të tij ndjenja dhe ndjesi;
- mëson që temave t'ju japë formë dhe t'i shfaqë përmes trupit
- fillon të dijë të sillt me anët e forta dhe me kufizimet e tij trupore;
- mëson të veprojë me kujdes;
- zhvillon vetëbesimin dhe guximin;
- fillon t'i masë aftësitë e tij trupore me të tjerët.

Perceptimi

Përmes perceptimit fëmijët vijnë në kontakt me veten e tyre dhe me botën e gjallë. Ata, përmes shqisave të ndryshme, perceptojnë trupin e tyre dhe njerëzit përreth. Ata shohin, dëgjojnë, nuhasin, shijojnë dhe ndiejnë. Të gjitha fushat janë ngushtë të lidhura mes vete.

Fëmija...

- përmes perceptimit të gjëseneve, situatave dhe proceseve krijon besim në botën përreth;
- percepton trupin e tij në kohë dhe hapësirë dhe përmes ndërveprimit me ambientin;
- ndërton përmes ndjenjave, ndjesive, mendimeve, kujtimeve dhe imagjinatës botën e tij të brendshme;
- di që, në përputhje me situatën, të shprehë edhe ndjenjat përmes mimikës;
- mëson t'i përshkruajë dhe t'i krahasojë perceptimet;
- fokuson vëmendjen dhe ushtron soditjen e saktë;
- ndërton, përmes përvojave, fushën e tij të koncepteve.

Orientimi kohor

Fëmijët duhet të mësojnë ta çmojnë me hamendje kohën, ta planifikojnë kohën dhe t'i përdorin si duhet resurset kohore, pasi që koha është një konstrukt social dhe jo ndjenjë të lindur. Evidentimi i kohës është një proces i gjatë dhe kompleks. Fëmijët mësojnë ta njohin dhe ta çmojnë këtë përmes përvojave të ndryshme.

Fëmija...

- di të dallojë konceptet kohore (p.sh. nesër apo pardje);
- të ndërtojë radhë apo lista;
- t'i thotë ditët e javës apo muajt;
- të reflektojë mbi strukturat e barabarta dhe të ndryshme ditore (ritmizimi);
- të kremtojë data të shënuara gjatë vitit (ditëlindjet dhe festa të tjera);
- të paraqesë kohën grafikisht (orën, muajt, ciklin vjetor);
- të dijë kryerjen e detyrave hap pas hapi, t'i kryejë ato dhe të reflektojë për to.
- Ta çmojë kohëzgjatjen e kryerjes së veprimeve.

Orientimi hapësinor

Fëmijët ndërtojnë përmes përvojave të tyre një paramendim kognitiv mbi ambientin e tyre të afërt apo të largët, që u mundëson atyre të orientohen. Përmes përvojave të ndryshme në hapësirë, fëmijët fitojnë aftësitë bazë për orientim.

Fëmija...

- zbulon hapësirën e tij jetësore (rrethin e tij të banimit, ambientin e shkollës së tij , rrugën për në shkollë);
- nje shfrytëzimin e ndryshëm të hapësirave (hapësirave të brendshme dhe të jashtme);
- nje karakteristikat hapësinore, kontekstet dhe funksionet
- vizaton dhe përshkruan hapësirat nga përvoja e tij jetësore dhe nga fantazia;
- lexon dhe kupton paraqitjet e thjeshta të hapësirave (p.sh. planet, hartat vizatimore, fotografitë).

Kontekstet dhe ligjshmëritë

Fëmijët kanë një interesim të natyrshëm për botën. Ata zhvillojnë herët konceptet e tyre mbi natyrën e prekshme dhe atë të paprekshme si dhe mbi relacionet ndër-njerëzore. Ata nxiten që të iniciojnë vetë veprimet e tyre, të kenë rastin të luajnë dhe të eksplorojnë bashkë dhe të këmbëjnë, në biseda të përbashkëta, përvojat dhe njohuritë e tyre.

Fëmija...

- krijon kontekste dhe ligjshmëri kauzale;
- krijon ide dhe koncepte, që i përdor dhe i zbaton në përditshmëri;
- reflekton konceptet e tij dhe i zhvillon ato më tej, i nxitur nga pyetjet se «pse është kjo kështu?» ose «për çka shërben kjo?»;
- diferencën imazhin e tij mbi botën.

Fantazia dhe kreativiteti

Proceset kreative zhvillohen te fëmijët kryesisht në mënyrë të pa strukturuar, pjesërisht të vetëdijshme dhe spontane. Fëmijët reagojnë ndaj perceptimeve të brendshme dhe të jashtme duke i shprehur ato dhe duke i vënë në një konstelacion me përvojat dhe njohuritë e tyre. Një fëmijë me fantazi të pasur posedon një shumësi të madhe të imazheve dhe të ideve.

Hapësirat e lira, nxitja dhe përkrahja sfidojnë format kreative të të shprehurit. Kreativiteti ka një rëndësi të veçantë kudo ku fëmija...

- luan lirshëm;
- provon format e paraqitjes së gjërave të përjetuara dhe të provuara;
- konfrontohet aktivisht dhe në mënyrë të pavarur me ambientin përreth;
- i mendon në një formë të re gjërat e perceptuara dhe i zhvillon ato më tej;
- krijon pikëpamje tjera dhe zgjidhje jo të zakonshme.

Të mësuarit dhe reflektimi

Fëmijët, gjatë zhvillimit të tyre, zgjerojnë mundësitë e të mësuarit: ata ju qasen në mënyra të ndryshme temave të ndryshme, nxiten nga impulse të jashtme dhe tema të ndryshme, njohin ushtrime, sodisin, krahasojnë, rendisin, imitojnë, zbatojnë, provojnë, supozojnë, interpretojnë etj. Shumë prej këtyre gjërave ndodhin në formë loje, që në mënyrë suksese plotësohen edhe përmes formave sistematike të të mësuarit. Në ciklin e parë një rol qendror luan të mësuarit përmes soditjes dhe imitimit si dhe të demonstrimit dhe imitimit (mësimi të modeleve). Me këtë rast fëmijët mësojnë shumë si nga njëri-tjetri dhe me njëri – tjetrin ashtu edhe nga të rriturit. Duke reflektuar veprimet, imazhet, gjuha, simbolet dhe mendimet ndërliken mes vete për të qartësuar, klasifikuar dhe sqaruar.

Fëmija...

- mediton mbi veprimtaritë objektive dhe sociale;
- krahason të rejtat me të njohurat;
- planifikon veprimin dhe të mësuarit e tij dhe përqendron vëmendjen në arritjen e qëllimeve
- përpunon një përjetim konkret përkatësisht një soditje përmes vizatimit apo gjuhës;
- bisedon mbi mundësitë e ndryshme të paraqitjes së një njësie mësimore apo të një mënyre të qasjes

Gjuha dhe komunikimi

Fëmijëve përmes gjuhës bota ju bëhet e qasshme dhe ju shpjegohet atyre duke i shprehur me fjalë përjetimet, përvojat dhe ndijimet e tyre. Gjuha luan një rol fundamental në zhvillimin e të menduarit, të krijimit të kontakteve sociale, të zgjidhjes së problemeve dhe të përvetësimit të kompetencave metodike dhe strategjike. Fëmijët, për t'u shprehur, shfrytëzojnë një spektër të gjerë të mjeteve shprehëse dhe të komunikimit.

Fëmija...

- nxitet të shprehet në një grup të madh;
- krijon raste të ndryshme të të shprehurit, si: marrëveshje, sqarime dhe arsytetime, rrëfime, përshkrime, prezantime, përjetime, tregime dhe situata loje;
- zgjeron fjalorin e tij dhe mundësitë e tij shprehëse;
- gjen forma të tjera shprehëse përmes muzikës, artit figurativ dhe lëvizjes.

Mëvetësia dhe veprimi social

Fëmijët, në ciklin e parë, e përjetojnë veten e tyre si persona të mëvetësishëm, të cilët e provojnë botën, marrin iniciativën për kryerjen e pavarur të detyrave, zhvillojnë forca dhe diferencojnë vetëvlerësimin. Njëkohësisht fëmijët mësojnë futjen në një grup të madh të bashkëmoshatarëve, njohin lidhje të ndryshme dhe mësojnë t'i ndërtojnë ato. Ata mësojnë t'i marrin parasysh interesat dhe dëshirat e fëmijëve të tjerë, të kooprojnë dhe t'i zgjidhin problemet me apo pa ndihmë.

Fëmija...

- zhvillon besim në aftësitë dhe shkathhtësitë e tij dhe di t'i çmojë ato;
- merr në mënyrë të vazhdueshme përgjegjësi për veprimet e tij;
- mëson t'i integrojë mendimet e të tjerëve në mendimet e tij (marrja përsipër në mënyrë perspektive);
- mëson, që varësisht nga situata, t'i plasojë apo t'i tërheqë mendimet e tij në grup
- është në gjendje t'i shkruajë dëshirat e tij afatshkurtra dhe t'i ndjekë qëllimet e tij afatgjata;
- ushtron t'i rregullojë emocionet e tij;
- zgjeron tolerancën e frustrimit të tij.